

Titulli: Vetëdijësimi mbi rëndësinë e imunizimit të rregullt, kyç për rritjen e shkallës së imunizimit tek fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Nëntitulli: Fushata ‘*derë më derë*’ synon vetëdijësimin e prindërve dhe kujdestarëve mbi rëndësinë e imunizimit të rregullt

Ferizaj, Maj 2022 - Më kuriozitet po e shikon foton e vullnetarit Ruzhdi Bajrami nga fushata ‘*derë më derë*’, që falë tij dhe vullnetarëve të angazhuar në projekt, djali i saj 6 vjeçar u vaksinua me vaksinën MMR, e cila parandalon tri sëmundje serioze. Është kjo Milikie Kadrollie nga komuna e Ferizajt, nënë e gjashtë fëmijëve.

Ajo tani fëmijët i ka të rritur, me i vogli 6 vjeçar, kurse më i madhi 20. Për vaksinimin e fëmijëve të saj, Milikia dëgjoi vetëm nga mantilbardhët në momentin kur u bë nënë për herë të parë. Nga atëherë ajo vaksonoi secilin fëmijë.



Foto 1. Milikie Kadrollie nga Ferizaj ka gjashtë fëmijë dhe të gjithë janë të vaksinuar (photo e shkrepur në zyret e OJQ BRAN në Ferizaj).

Milikie tregon se vendimi për t’i vaksinuar fëmijët e saj nuk ishte i lehtë, duke pasur parasysh paragjykimet që kishte në familjen dhe rrethin e saj.

“Më kanë thënë ‘qysh po i vaksinon, a e din që të jetë fëmija i paralizum, mos i ngo çka të thojnë’, ama unë më burrin tim e kemi pa që më mirë është m’i vaksinu dhe tash gjashtë fëmijët i kam të shëndoshë”, shprehet Milikia.

“Unë kam fol edhe me shoqe e gratë e lagjes dhe ju kam thanë vaksinoni fëmijët sepse është për të mirën e fëmijëve tuaj”, vazhdon rrëfimin e saj Milikia.

Shembullin e Milikies e ka ndjekur edhe Bedri Haniqi, 35 vjeçar nga lagjia e Sallahanes në Ferizaj. Bedriu fillimisht hezotoi t’i vaksinojë fëmijët e tij, derisa kuptoi për rëndësinë që ka vaksinimi i rregullt i fëmijëve.

“Djalin e madh. që tash është 15 vjet, e kam vaksinu pasi ka lind fëmija i dytë, kur ka qenë 3 vjeç, e mandej të dytë i kam vaksinu në të njëjtën kohë. Të tjerët i kam vaksinu qysh prej kur kanë lind”, tregon Bedriu. “Kam gabu me djalin e parë, të njëjtën gjë më nuk e kam përsërit me fëmijët tjerë”.

Ai çdo ditë është në kontakt me njerëz të ndryshëm nga komunitetet rom, ashkali e egjiptian, të cilëve u flet për rëndësinë e imunizimit të fëmijëve sipas kalendarit të rregullt të imunizimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKShP).



Foto 2. Kam gabu [që nuk e kam vaksinuar me kohë] djalin e parë, mirë të njëjtën gjë më nuk e kam përsërit me fëmijët tjerë.

“Sa herë që më ipet rasti diskutoj me persona të ndryshëm, por edhe familjarë që hezitojnë t’i vaksinojnë fëmijët e tyre. Mundohem t’ua sqaroj se pse duhet t’i dëgjojnë mjekët kur na udhëzojnë për vaksinim” thotë Bedriu.

Vaksinimi mundëson eliminimin e shumë sëmundjeve serioze, dhe në këtë mënyrë parandalon përhapjen e tyre në komunitet.

Përmes vaksinimit, fëmijët në Kosovë mbrohen nga 10 sëmundje serioze

Sipas ligjeve në fuqi, në Kosovë vaksinimi është i obliguar që nga lindja deri në moshën 18 vjeçare. Kalandari i rregullt i imunizimit propozohet nga IKShP dhe aprovohet nga Ministria e Shëndetësisë. Aktualisht pjesë e kalendarit të rregullt janë 10 vaksina, duke përfshirë vaksinat kundër Tuberkulozit, Hepatitit B, Difterisë, Tetanosit, Pertusisit (Kolla e bardhë), Hemofilus Influenzës B, Fruthit, Rubellës, Parotitit si dhe Poliometitit.

Përkundrejt përpjekjes së vazhdueshme të institucioneve shëndetësore dhe vullnetarëve në terren, shkalla e imunizimi të fëmijëve në Kosovë është ende jo e kënaqshme. Në veçanti, shqetësuese mbetet shkalla e ulët e vaksinimit tek fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas të dhënave nga Anketa e Treguesve të Shumfishtë, të bërë më 2020 nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës në bashkëpunim me UNICEF, shkalla e imunizimit të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është vetë 38%, ndryshe nga popullata shumicë ku shkalla e imunizimit arrin në 73%.

Për të arritur tek familjet e këtyre komuniteteve, Balkan Sunflower Kosova në bashkëpunim me UNICEF në Kosovë kanë filluar fushatën vetëdijësuese ‘*derë më derë*’, ku vullnetarët tash e dy vite janë të angazhuar në 14 komuna të Kosovës për t’i ndihmuar familjet nga këto komunitete.

Rreth dy vite, mbi 8 mijë familje janë vizituar derë më derë, ndërsa mbi 6 mijë fëmijë janë vaksinuar nga ekipet mobile të vaksinimit, të koordinuara nga vullnetarët e organizatës Balkan Sunfloëers Kosova.

Ferizaj është njëri nga qytetet ku po zhvillohet kjo fushatë. Atje, vullnetarët çdo ditë vizitojnë familjet nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, me qëllim të ngritjes së vetëdijës për rëndësinë e imunizimit të rregullt, si dhe për ofrimin e mundësisë së vaksinimit të fëmijëve të

cilët nuk janë vaksinuar, përmes koordinimit të fushatës së vaksinimit plotësues me Qendrat e Mjekësisë Familjare të Ferizajt.

Fushata ‘*derë më derë*’ zhvillohet në 14 komuna, mbështetet nga UNICEF dhe implementohet nga Balkan Sunflowers Kosova.



Foto 3. Fushata 'derë më derë' synon vetëdijësimin e familjeve për imunizimin e rregullt të fëmijëve, si dhe identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar, të cilët pastaj vaksinohen nga ekipet e Qendrave të Mjekësisë Familjare përmes vaksinimit plotësues. Rreth dy vite, falë punës së vullnetarëve, mbi 8 mijë familje janë vizituar ndërsa mbi 6 mijë fëmijë janë vaksinuar.